

VENDIM
Nr.305, datë 24.5.2006

PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV DHE
MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË ARRIJNË KËTO NIVELE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 26, të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për të rritur, në sportet individuale, në përbërje të ekipit kombëtar dhe të ekipeve kombëtare të sporteve kolektive, futboll, basketboll, volejboll, atletikë, gjimnastikë, mundje, peshëngritje, boks dhe qitje, të jenë rezultatet e arritura në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, si më poshtë vijon:

- a) Sportisti, i cili thyen rekord olimpik;
- b) Sportisti, i cili thyen rekord botëror;
- c) Sportisti, i cili thyen rekord europian;
- ç) Vendi i parë deri në vendin e tetë në lojërat olimpike;
- d) Vendi i parë deri në vendin e gjashtë në kampionate botërore;
- dh) Vendi i parë deri në vendin e tretë në kampionate europiane;
- e) Vendi i parë në lojërat mesdhetare.

Klasifikimi i ekipeve në sportet individuale nuk merret parasysh në kategorizimin e mësipërm.

2. Sportistët, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të shpërblehen sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Trajnerët e sportistëve të nivelit të lartë të shpërblehen në masën 30 për qind, mbështetur në kategorizimin dhe vlerat e përcaktuara në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Sportistët e përcaktuar në pikën 1, përfitojnë këto të drejta.

- Të drejtën e studimit në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sportit, pa konkurrim.

- Kryerjen e studimeve akademike, sipas një plani individual, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

- Të drejtën e përfitimit të pensionit të posaçëm shtetëror, me arritjen e moshës së pensionit, sipas procedurave të parashikuara në vendimin nr.429, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela e parë

Lojra mesdhetare	Vendi i parë	3 000 000 lekë
Kampionat europian	Vendi i parë	5 000 000 lekë
Kampionat europian	Vendi i dytë	3 000 000 lekë
Kampionat europian	Vendi i tretë	2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	8 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	6 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i katërt	4 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i pestë	3 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	2 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i parë	15 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i dytë	10 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i tretë	7 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i katërt	4 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i pestë	3 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i gjashtë	2 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i shtatë	1 000 000 lekë
Lojrat olimpike	Vendi i tetë	500 000 lekë
Rekord olimpik		15 000 000 lekë
Rekord botëror		15 000 000 lekë
Rekord europian		8 000 000 lekë